

Në bazë të nenit 50 paragrafi 3 të Ligjit për duhanin, produktet e duhanit dhe produkteve të përafërta (*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.98/19 dhe 27/20), ministri i Ekonomisë miratoi

RREGULLORE PËR KUSHTET MË TË AFËRTA PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E EKSPORTUESVE DHE IMPORTUESVE TË PRODUKTEVE TË DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË PËRAFËRTA

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet më të afërta për regjistrim në Regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta.

Neni 2

Magazina e produkteve të gatshme duhet të jetë objekt, respektivisht hapësirë në të cilën ushtrohet marrja përsipër, ruajtja dhe përgatitja e produkteve të duhanit dhe produktet e përafërta, për zhvillimin e papenguar të eksportit ose/dhe importit dhe shpërndarjen e tyre në treg në përputhje me dispozitat e Ligjit për akcizat (*¹).

Neni 3

Magazina duhet të jetë e ndërtuar nga materiali i fortë në pëlqim me rregullat për planifikim dhe ndërtim të objekteve.

Neni 4

Magazina duhet të ketë hapësirë manipuluese për shkarkim dhe ngarkim të papenguar të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta dhe pajisje për marrjen përsipër dhe seleksionimin e produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta, sipas llojit dhe markave, respektivisht magazinimin të rregullt të të njëjtave.

Neni 5

Magazina duhet të ketë ujë të rregullt higjienik, ndriçim natyror ose artificial dhe ajrosje dhe pajisje për vendosjen e produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta, në mënyrën që mundëson qasje të papenguar dhe mbrojtje të produkteve nga ndotja dhe nga ndikimet e dëmshme mbi cilësinë dhe rregullsinë e produkteve.

Neni 6

Magazina duhet të ketë një ose më shumë hyrje për shfrytëzuesit dhe kushte të siguruara për dërgim dhe përgatitje të papenguar të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta.

(*1) Ligji për akcizat është harmonizuar me 1. DIREKTIVËN E KËSHILLIT 2008/118/KE më 16 dhjetor të vitit 2008 në lidhje me aranzhimet e përgjithshme për akcizat dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/BEE; 2. DIREKTIVA E KËSHILLIT 2003/96/KE e 27 tetorit për ristrukturimin e kornizës së Bashkësisë për tatimin e produkteve energjetike dhe energjisë elektrike; 3. DIREKTIVA E KËSHILLIT 92/83/BEE e 19 tetorit 1992 për harmonizimin e strukturave të akcizës së alkoolit për pije alkoolike; 4. DIREKTIVA E KËSHILLIT 92/84/BEE e 19 tetorit 1992 për harmonizimin e normave të akcizës së alkoolit për pijet alkoolike; 5. DIREKTIVA E KËSHILLIT 2011/64/BE e 21 qershorit 2011 për strukturën e akcizës dhe normat e akcizës që kanë të bëjnë me duhanin e përpunuar; 6. RREGULLATIVA E KOMISIONIT (BE) Nr. 31/96 e 10 janarit 1996 për vërtetimin e lirimt nga akciza; 7. DIREKTIVA 2006/79/BE e Këshillit për lirim nga tatimi gjatë importit të dërgesave të vogla të mallrave të karakterit jokomercial nga vendet e treta; 8. DIREKTIVA E KËSHILLIT 2007/74/BE për lirim nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe akciza për mallrat e importuara nga personat që udhëtojnë nga vendet e treta dhe 9. DIREKTIVA E KËSHILLIT 95/60/BE e 27 nëntorit 1995 për shënuesit fiskal të vajit dhe kerozinës.

Neni 7

Nga pajisja personi juridik që ushtron eksport dhe import të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta duhet të ketë karrocë dore ose pajisje tjetër për ngarkim dhe shkarkim.

Neni 8

Personi juridik që ushtron eksport dhe import të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta duhet të ketë punuar së paku një person, që i përmbushë kushtet nga neni 50 paragrafi 2 alineja 3 e Ligjit për duhanin, produktet e duhanit dhe produktet e përafërta (*).

Neni 9

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja për kushtet për eksport dhe import të produkteve të duhanit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.31/07).

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e radhës nga dita e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 11-2218/4

29 maj viti 2020
Shkup

Ministër i Ekonomisë,

Kreshnik Bekteshi, n.p.